



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim dt 26.12.2024 , më poshtë do të gjeni informacionin e kërkuar:

1. Cilat janë zonat e prekura (fshatrat, pyjet, shtigjet etj) dhe sa hektarë janë prekur në secilën zonë të përshkruar? 2. Ju lutem, sipërfaqen totale për secilën zonë dhe shkallën e prekjës të këtij volumi (Pra, raportin).

Ne vitin 2019 nga specialistët e pyjeve të Bashkisë Shkodër , vihemi në dijeni se në ekonominë pyjore “Lugina Kirit” është shfaqur një insekt në kulturën e gështenjës , insekt i cili nuk është hasur më parë dhe ka një përhapje të shpejte . Ky insekt është konstatuar në masivin e gështenjave në fshatin Xhan dhe zonat përreth. Sipërfaqja e prekur konsiderohet të jetë rreth 1000 Ha me një densitet 30-50% te individëve.

Në vitin 2020 Nga specialistët e pyjeve njoftohemi se këtë vit janë infektuar rreth 1124 ha sipërfaqe pyjore me gështenjë me një densitet 30-40% te individëve. Kjo e përhapur ne në zonën e Dukagjinit , kryesisht në Ekonomitë Pyjore Lugina e Kirit, EP Shosh 1 , EP Brucaj EP Rosek Drisht ,EP Shalë1 dhe EP Shalë 2,

3. A keni një raport, apo një dokument që përshkruan këtë historik; nëse po, ju lutem të ma dërgoni.

Sic edhe shihet me siper kjo situatë ka filluar ne vitin 2019 dhe ne vitin 2020 me pas situata nuk u perkeqesua më. Gjatë vitit 2021 situata qëndroi e pandryshuar , dhe më pas kjo situatë filloi të përmirësohet . Kjo për faktin se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural , si institucioni përgjegjës për marrjen e masave, ndërhyri me importimin e insektit që luftonte grerëzën galëformuese në masivin e gështenjës në Rec (Bashkia Malësi e Madhe) po ashtu ndërhyri edhe në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar të Thethit , Ekonomitë Pyjore Shalë 1 edhe Shalë 2.

4. Lidhur me insektin e dëmshëm që ka prekur gështenjën, a keni kryer monitorime vjetore? Nëse po, a mund të më dërgoni rezultatet e monitorimeve?

Ne tabelen 1 bashkelidhur do te gjeni monitorimet ne vite.

5. Sa është shumë e përgjithshme e shpenzuar, nga 2018, për rikuperimin e pyjeve të dëmtuara? Ju lutem, të m'i shpërndani sipas zërave dhe sipas viteve në të cilat janë përdorur.

Lidhur me luftimin e grerezez ne geshtenje nuk kemi pasur fonde investim/sherbim. Per me shume mund te konsultoni linkun

<https://buxheti.info/shkoder/>

6. Cila janë sipërfaqet e trajtuara (sa hektarë dhe për çfarë trajtimi bëhet fjalë, konkretisht? Pra, fjala është jo vetëm për të luftuar insektin, por edhe shërbime të tjera: pastrim, krasitje, mirëmbajtje fondi pyjor etj.

Bashkia Shkodër nuk ka ndërhyrë për të trajtuar masivin e gështenjës me luftim biologjik. Kjo ka qënë e pamundur si nga ana financiare ashtu edhe nga ana e zbatimit të procedurës. Per informacionet e tjera mund te informoheni neprmjet linkut :

<https://buxheti.info/shkoder/>

7. Cilat janë projektet (në bashkëpunim me organizatat apo grupet e mëdha financiare: BB, BE, FAO, Ministria e Bujqësisë etj) që keni zhvilluar për trajtimin e këtij problemi)?

Nuk kemi patur

8. A parashikoni fonde nga bashkia për administrimin e pyjeve të gështenjës në pesë vitet e ardhshme? Konkretisht, për cilat zëra?

Nuk parashikohet

9. Sa i madh është dëmi ekonomik i shkaktuar nga dëmtimi: në hektarë të prekur; në prodhim; në të ardhura? (Nëse keni ndonjë raport apo ndonjë vlerësim për këtë)?

Nuk kemi vlerësim .

KRYETAR

Benet BECI